



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:122106

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06216271

C.nr.863/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, çështjen juridike kontestimore të paditësi M.H. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.B.M. nga Prizreni, kundër të paditurit J.B. nga Prizreni,..... të cilin e përfaqësojnë me autorizim av. D.Sh. dhe av. N.M. nga Prizreni, për kompensimin e dëmit jo material për shpifje dhe fyerje, vlera e kontestit 30.000, jashtë seancës me datë 26.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET POSHTË SI E PASAFATSHME padia e paditësit M.H. nga Prizreni, e ushtruar kundër të paditurit Jeton Bytyqi nga Prizreni, për kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes dhe fryjës, e evidentuar me numër C nr.863/2019, për shkak se padia është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj.

II. DETYROHET paditësi M.H. nga Prizreni, që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë të paditurit J.B. shumën prej 208 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M.H. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.B.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me date 07.05.2019 kishte parashtruar padinë kundër të paditurit J.B. nga Prizreni, për kompensimin e dëmit për shkak të shpifjes dhe fyerjes Në padi ndër të tjera është theksuar se me datën 06.03.2018, përmes rrjeteve sociale, llogarisë se tij në Facebook , i padituri kishte publikuar një shkrim në të cilin ka shpifur dhe ka fyer këtu paditësin. Në padi është theksuar se shkrimet e lartshënuara janë përdorë shprehje dhe fjalë fyese, nënçmuese, degraduese dhe poshtëruese për paditësin. Andaj, ndër të tjera gjykatës i kishte propozuar që të caktoi shqyrtim gjyqësor dhe pas administrimit të provave të aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

I padituri J.B. nga Prizreni, nëpërmjet të autorizuarit të tij av. D.Sh. nga Prizreni , pranë kësaj gjykate me date 20.09.2024 ka parashtruar përgjigjja në padi, ku e ka kundërshtuar padinë e paditësit duke faktin se padia e paditësit është paraqitur jashtë aftit ligjore te parapare nga neni 17 Me nenin 17 par. 1 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes, Ligj n. 02/L-65.

Me nenin 17 par. 1 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes, Ligj n. 02/L-65 është paraparë që *“Afati për paraqitjen e një kërkesë për kompensim në bazë të këtij ligji është tre (3) muaj, nga dita kur personi që pretendon të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pa vërtetë dhe identitetin e autorit, dhe në asnjë raste nuk duhet të kaloj një (1) vit, nga dita kur shprehja është bërë publike”*.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe meqenëse kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit i cili është shkaktuar përmes shpifjes, ku janë të përcaktuar afatet ligjore për paraqitjen e padisë në gjykatë, gjykata ka konstatuar se paditësi kishte humbur afatin për paraqitjen e padisë në fjalë. Dispozitat ligjore të cituara si më lartë kanë paraparë dy afate ligjore për paraqitjen e padisë përmes të së cilës kërkohet kompensim i dëmit të shkaktuar nga shpifja dhe atë afatin subjektiv i cili është tre muaj, ndërsa afati objektiv i cili është 1 vit nga dita kur është publikuar shpifja. Afati subjektiv fillon të rrjedh nga dita kur personi që pretendon të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pa vërtetë dhe identitetin e autorit. Pra, duke i marr për bazë këto gjykata ka vërtetuar se shpifja e pretenduar nga paditësi kishte ndodhur me datën 06.03.2018, kur edhe është publikuar artikulli në portalin “ 04 Online ” ku është shënuar edhe autori i tekstit, datë kjo kur edhe vet paditësi e kishte lexuar këtë artikull (pra po të njëjtën ditë, “...ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pa vërtetë dhe identitetin e autorit), gjë të cilën e pranon vet paditësi në padinë e tij, ku ndër të tjera kishte theksuar se “...i padituri Jeton Bytyç , më datën 06.03.2018, përmes rrjeteve sociale dhe, portalit “04 Online”, ka publikuar një shkrim...”. Nga këto të cekura gjykata ka ardhur në përfundim se, paditësi me datën 07.06.2019, ishte në dijeni për shpifjen e pretenduar dhe personin i cili e kishte bërë këtë shpifje, kur edhe kishte filluar të rrjedh afati subjektiv për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në rastin konkret. Në anën tjetër paditësi padinë e tij në gjykatë e kishte ushtruar me datën 06.03.2018, apo pas kalimit të më shumë se 15 muajve, gjë e cila padinë e paditësit e bënë të pasafatshme, andaj gjykata të njëjtën e kishte hudhur poshtë si të tillë sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale sikurse në pikën nën III të dispozitivit të aktgjykimit është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452 par. 2 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke e obliguar paditësin për kompensimin e shpenzimeve ndaj palës se paditur, gjykata e ka vlerësuar të bazuar dhe të qëndrueshme shumën prej 208 euro, dhe atë për padinë shumën prej 208 euro.

Andaj, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me kalimin e afatit për parashtrimin e padisë në këtë çështje juridiko kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 391 pika f të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:122106
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06216271

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.863/2019, me datë 26.09.2024

Gjyqtari

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.